KËRKESË
Nr.3379, datë 1.6.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Dhërmi-Vuno.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve, nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 507 465 (pesëqind e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë.

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR DHËRMI-VUNO

Nr.	Pronari	ZK	Nr.regjistri hipotekor	Kullotë			Shënime
	Emri			Sip.m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera lekë	
	Guliem Petro Trola						
	Vasilika Petro Gjini (Trola)						
	Liri Petro Kora (Trola)						
	Spiro Petro Trola						
	Kristina Petro Trola						
	Polikseni Trola						
	Edmond Foto Trola						
	Aleksandra Foto Trola						
	Agron Foto	3844	52	2531	200.5	507465.5	Konfirmuar nga

	Trola						ZRPP Vlorë
							Bashkëpronësi
	Totali				2531	507465.5	